

VENDIM
Nr. 63, datë 7.7.2014

PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË EMRIT TREGTAR TË SHOQËRISË “CEZ SHPËRNDARJE” SHA

Në mbështetje të nenit 9, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike” (i ndryshuar), vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 1, datë 10.1.2013, “Për miratimin e rregullores mbi procedurat e emërimit të administratorit dhe kompetencat e tij” (i ndryshuar), Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 7.7.2014, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a. për ndryshimin e emrit tregtar të shoqërisë.

konstatoi se:

Shoqëria “CEZ Shpërndarje”, në referencë të kompetencave të përcaktuara në vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 1 datë 10.1.2013, “Për miratimin e rregullores “Mbi procedurat e emërimit të administratorit dhe kompetencat e tij” (i ndryshuar), i propozon ERE-s:

- Ndryshimin e emrit tregtar të shoqërisë, nga shoqëria “CEZ Shpërndarje” sh.a., në shoqëria “Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike” sh.a. me akronimin “OSHEE” sh.a.

- Ndryshimin e selisë së shoqërisë nga adresa: Rruga “Abdyl Frashëri”, EGT Tower, pallati nr. 12/1, Tiranë, Shqipëri, në adresën: Rruga “Andon Zako Cajupi”, Pallati Conad, kati i 3-të, Tiranë, Shqipëri.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

- Miratimin e ndryshimit të emrit tregtar të shoqërisë, nga shoqëria “CEZ Shpërndarje” sh.a., në shoqëria “Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike” sh.a. me akronimin “OSHEE” sh.a.

- Miratimin e ndryshimit të selisë së shoqërisë nga adresa: Rruga “Abdyl Frashëri”, EGT Tower, pallati nr. 12/1, Tiranë, Shqipëri, në adresën: Rruga “Andon Zako Cajupi”, pallati Conad, kati i 3-të, Tiranë, Shqipëri.

- Të autorizojë administratorin e shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti